

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Papa Leo XIV nis sot vizitën në Francë, pritet nga qindra mijëra besimtarë
ADRESA	https://dosja.al/bota/papa-leo-xiv-nis-sot-viziten-ne-france-pritet-nga-qindra-mijera-be-simtare-i515986
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 12:27:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 12:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	acb5112b7d95e3eecea2a5bfd4ca0f3cdd3084619c5d7060aaafa055449abc6c
TEKSTI	cca48c9e6c293bf16e5c8fea7cd50877718f5fa559eb548a99af7199d41b1f26
PAMJA	311e3c59b3433fa3089a5d597871c5aac2dbcaa94c2d07d2b354c0bf0ada045d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e6ee7283dbff614b5576e77405e8e09c01a5b2d10fe7d10fad793c5e0a968002
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e6ee7283dbff614b5576e77405e8e09c01a5b2d10fe7d10fad793c5e0a968002>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

15 ORE ME PARE

Tensione dhe braktisje salle në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranian. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtra të pabaza

19 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

22 ORE ME PARE

Vlora Hyseni sulmon Klodiana Lalën para GJKKO-së, gazetarja: Shantazh. AGSH: Të tërheqë deklaratat (REAGIMET)

23 ORE ME PARE

Skandali SHISH/ Vlora Hyseni vë në rrezik vendin për Ergys Agasin: Të gjithë radarët e shtetit i mbyll për ty

Bota

Papa Leo XIV nis sot vizitën në Francë, pritet nga qindra mijëra besimtarë

Papa Leon XIV do të vizitojë Francën për katër ditë. Ai do të ndalet në Paris, Lourdes dhe Metz. Të gjitha aktivitetet publike janë rezervuar prej javësh. Vetëm në Paris, organizatorët presin të shtunën (26.09.2026) rreth një milion vetë në rrugë gjatë meshës së madhe papnore në Place de la Concorde.



25 Shtator 2026, 14:12
Nga E. D



Papa Leo

FRANCË- Franca është përfshirë nga ethet e vizitës së Papës. Në fakt, vendi prej më shumë se 200 vjetësh, sidomos pas ndarjes së rreptë ligjore midis shtetit dhe kishës në vitin 1905, karakterizohet nga tradita të forta laike. Megjithatë, ditët e ardhshme do të sjellin pamje krejtësisht të tjera.

Nga e premija (25.09.) Papa Leon XIV do të vizitojë Francën për katër ditë. Ai do të ndalet në Paris, Lourdes dhe Metz. Të gjitha aktivitetet publike janë rezervuar prej javësh. Vetëm në Paris, organizatorët presin të shtunën (26.09.2026) rreth një milion vetë në rrugë gjatë meshës së madhe papnore në Place de la Concorde. Kjo përputhet me faktin se Kisha Katolike në Francë po regjistron një rritje të papritur të pagëzimeve të të rriturve dhe një interes të ri për fenë.

"Papa gëzon popullaritet si te besimtarët, ashtu edhe te jobesimtarët", thotë politologu Olivier Roy për DW. Sipas tij, veçanërisht konflikti me presidentin e SHBA-së Donald Trump i ka dhënë kreut të Kishës një autoritet moral që shkon shumë përtej kufijve të Kishës Katolike.

Parisi përgatitet

Prandaj dhe fluksi i madh i njerëzve. Për 600.000 personat që kanë marrë bileta ka vend përgjatë gjithë Champs-Élysées deri te Harku i Triumfit. Megjithatë priten shumë më tepër vizitorë. Autoritetet kanë njoftuar tashmë mbylljen e një sërë stacionesh metroje. Në kisha dhe ndërtesa kishtarë janë vendosur portrete të mëdha të Papës dhe flamuj të Vatikanit. Për forcat e sigurisë kjo paraqet një sfidë të madhe.

Për politikën franceze, në një kohë kur zgjedhjet presidenciale do të mbahen pas pak më shumë se gjashtë

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi
Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se
ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i
Policisë së Krujës shan
qytetarin, ai zbrët nga makina
dhe e qëllon me shpullë
(VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe
krimi i organizuar u bënë
njësh në mbrojtje të Ergys
Agasit



muajsh, menaxhimi i kësaj vizite është gjithashtu një çështje delikate. Sipas Roy, e majta "e vlerëson personalitetin e Leonit, por është skeptike ndaj angazhimit të shtetit në organizimin e pritjes".

Forcat e forta të së djathtës ekstreme e mirëpresin evidentimin e katolicizmit, por kritikojnë, për shembull, takimin ndërfetar në Metz, sepse sipas tyre ai e vendos islamin në të njëjtin nivel me krishterimin. Për më tepër, presidenti nuk lejohet të marrë pjesë në meshat e mëdha publike për shkak të ndarjes së shtetit nga kisha.

Në çdo rast, Papa Leon po kontribuon për përmirësimin e imazhit të papatit. Vizita e fundit shtetërore e një Pape në Francë ishte në vitin 2008, kur Benedikti XVI vizitoi Parisin dhe Lourdën. Atëherë numri i vizitorëve ishte më i ulët sesa ai që pritet tani. Papa Françesku vizitoi Strasburgun në vitin 2014, Ajaccion në Korsikë në vitin 2024 dhe Marsejën në vitin 2023, por këto ishin gjithmonë vizita të lidhura me ngjarje të veçanta, jo vizita në të gjithë vendin. Fjalimet e tij në Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Evropës në Strasburg sollën kritika të ashpra ndaj një Evrope që ai e quante të lodhur.

Ati i Shenjtë dhe "vajza më e vjetër"

Në gjuhën kishtarë Franca konsiderohet si "vajza më e vjetër e Romës". Kjo lidhet me kristianizimin e hershëm të vendit në fillim të shekullit të gjashtë. Që në shekullin e dytë pas Krishtit u formuan bashkësitë e para të krishtera. Kjo bie në kontrast me qëndrimin disi të ftohtë që Françesku shfaqte ndaj Francës.

Olivier Roy thekson dallimet në këndvështrimet e papëve të fundit. Gjon Pali i II e shihte krishterimin kryesisht si një fenomen evropian, ndërsa Françesku si diçka më të lidhur me hemisferën jugore. Kjo, sipas tij, shpjegon njëfarë nënvlerësimi të Evropës. Roy e sheh Leon si një figurë të ndërmjetme: "Ai e pranon universalitetin e Kishës Katolike, por në të njëjtën kohë njeh peshën e Evropës brenda këtij universaliteti." Megjithatë, Leoni vazhdon të mbështetet edhe në mesazhin e paraardhësit të tij.

Roli i Evropës për papët

Historiani i Kishës dhe eksperti i Papës, Jörg Ernesti nga Augsburgu, thekson se Evropa ka qenë që nga fundi i shekullit XIX pika më e rëndësishme politike e referimit për papët. Kjo mbetet e vërtetë edhe sot, pavarësisht ndërkombëtarizimit në rritje të krishterimit.

Ernesti kujton statistikën: në vitin 1900 më shumë se dy të tretat e të gjithë katolikëve jetonin në Evropë, ndërsa sot vetëm rreth 20 për qind. Me një vonesë kohore, ky ndryshim po reflektohet edhe në Kolegjin e Kardinalëve. Ndërsa dikur evropianët ishin gjithmonë shumicë, sot ata përbëjnë vetëm 39 për qind.

Gjatë katër ditëve të vizitës, Papa Leon do të mbajë 15 fjalime dhe predikime. Shumica do t'i drejtohen shoqërisë franceze dhe drejtuesve politikë, ndërsa gjatë meshave të mëdha dhe në Lourdë fokusi do të jetë te besimtarët.

Megjithatë, vëmendja më e madhe përqendrohet tek fjalimi për Evropën, që do të mbahet në ditën e fundit në Metz dhe që do të prezantohet nga vetë presidenti Macron. Tema e tij është: "Te rrënjët e Evropës për paqe dhe unitet".

Vetë Metz ka një rëndësi të veçantë simbolike. Dikur qendër e Perandorisë Karolingiane, qyteti ka ndryshuar disa herë gjuhën dhe përkatësinë shtetërore gjatë shekujve. Herë ishte gjerman dhe herë francez.

Në Qendrën e Kongreseve "Robert Schuman", Papa Leo do të mund t'i referohet figurës nga e cila institucioni mban emrin. Robert Schuman (1886-1963), i lindur në Luksemburg dhe fillimisht shtetas gjerman, ishte një burrë shteti francez që pas katastrofës së Luftës së Dytë Botërore promovoi pajtimin franko-gjerman. Ai mbështeti fuqishëm krijimin e një Evrope të bashkuar dhe në vitin 1958 u bë presidenti i parë i Parlamentit Evropian. Pas vdekjes së tij, ai u varros në një kishë të vogël pranë Metzit.

Sipas Roy, për këtë Papë "Evropa është një unitet real, që duhet të mbështetet dhe zhvillohet përtej nacionalizmave." Ky, sipas tij, ka qenë gjithmonë mesazhi i Kishës Katolike që nga Lufta e Dytë Botërore. "Është mesazhi i Schumanit." Qyteti i Metzit dhe figura e Schumanit janë simbole të fuqishme të kësaj ideje.

Roy është gjithashtu kurioz të shohë nëse dhe sa hapur Papa Leon do të kritikojë populizmin dhe nacionalizmin, përfshirë një formë nacional-katolicizmi që gjendet në Francë. Sipas tij, mbështetësit e meshës së vjetër latine janë shpesh "nacionalistë identitarë ose persona të afërt me të djathtën ekstreme".

Papa Leo takon viktimat e abuzimeve

Asnjë udhëtim papnor nuk mund të shmangë temën e abuzimeve. Kur Benedikti XVI vizitoi Francën në vitin 2008, ai nuk u takua me viktimat të dhunës seksuale në Kishën Katolike. Megjithatë Kisha franceze vazhdon edhe sot të përballlet me skandale të reja dhe ka reaguar me vonesë në trajtimin e tyre.

Këtë herë, një takim i tillë është pjesë e programit gjatë qëndrimit në Lourdë. Por diçka ka ndryshuar. Në kohën e Benediktit dhe Françeskut, personat me të cilët takoheshin papët shpesh mbeteshin anonimë. Kjo krijonte përshtypjen se Vatikani u jepte akses në këmbim të heshtjes. Në Francë, shtatë viktimat që do të takohen me Leon

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 07:44

"O Kriminel, o mafia"/
Shqiptarët qëllojnë me vezë
Edi Ramën në SHBA: E gjithë
Shqipëria ty të urren

më të klikuarat



"O Kriminel, o mafia"/
Shqiptarët qëllojnë me vezë
Edi Ramën në SHBA: E
gjithë Shqipëria ty të urren

Asambleja e Përgjithshme e
OKB-së, kryeministri Rama
mban sot fjalimin e tij në
hapje të debatit

"Të q'fsha motrën"/ Shefi i
Policisë së Krujës shan
qytetarin, ai zbrit nga
makina dhe e qëllon me
shpullë (VIDEO)

A e fshehu telefonin Ilir
Proda? Gazetari Ferhati: Në
SPAK deklaroi se i ishte
thyer

insights

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim
po ndërtohet një
pallat

Auron Janku

Kur PARTITË
harrojnë pse
ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1
euroshit ku Rama
zgjedh kush bëhet
biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi
shqiptar për tu
përshtatur me
tregun e BE-së?

Moti

Powered by tomorrow.

kanë folur publikisht paraprakisht dhe pesë prej tyre kanë bërë publik edhe emrin e tyre.

"Dialogu nuk do të thotë miratim", deklaruan ata. "Të pritemi nuk do të thotë të heqim dorë nga kërkesat tona."

Kjo çështje do të vazhdojë të mbetet një sfidë për Kishën, si në Francë ashtu edhe më gjerë, për një kohë të gjatë.
/DW

papa leo

Sondazh

Poll

Beta

25 Shtator 2026, 14:09

Vuçiç akuzon Nenad Rashiq: Po zbaton verbërisht urdhrat e Albin Kurtit

Aleksandar Vuçiç SERBI- Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, e ka akuzuar politikanin nga Kosova, Nenad Rashiq, se, si&...

Nga Titanët e teknologjisë te “Kurthi i Thukididit” dhe dollia simbolike/ PRAPASKENAT e darkës Trump-Xi në Shtëpinë e Bardhë

Beta

25 Shtator 2026, 10:20

Ministri i Jashtëm iranian: I kemi paraqitur SHBA-së planin për rihapjen e Hormuzit

Beta

25 Shtator 2026, 10:15

Teksa Trump dhe Xi takohen, rritet presioni për konfrontimin me Kinën për mbështetjen ndaj Iranit

Beta

25 Shtator 2026, 09:07

"Swan Song: Diana, motra ime"! Pse një libër për Princeshën Diana po shkakton kaq bujë?

Beta
25 Shtator 2026, 08:31

Beta
25 Shtator 2026, 08:13

Analiza e DW: Ekonomia gjermane po rimëkëmbet, por për sa kohë?

foto ilustruese GJERMANI- "E kemi lënë pas periudhën e ngecjes dhe tkurrjes ekonomike", thotë Kancelari gjerman Friedrich M...

Aleksandër Vuçiç: Do të japë dorëheqjen të dielën në mbrëmje, por do të flas me Putinin para përfundimit të mandatit

Beta
25 Shtator 2026, 08:02

Armët nga Bosnja dhe lidhjet e rrjeteve kriminale në Suedi me Iranin: Çfarë zbulon hetimi?

Beta
25 Shtator 2026, 07:41

Tragjedi në SHBA/ Mësuesja dhe nxënësi humbin jetën gjatë ekskursionit shkollor

Beta
24 Shtator 2026, 23:00

Lufta në Lindjen e Mesme/ Netanyahu në OKB: Rrëzimi i regjimit iranian është

MË SHUMË



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.